



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

**K.P.P 425/2017**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.06.2017 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-05987-04-13-2017, me objekt “Sistemim Asfaltim Rruga Dragot – Pasarele”, me fond limit 46.796.083 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 15.05.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tepelenë.

**Ankimues:**

“Cobial” shpk  
Rr: “Milto Tutulani”, Nd.2, H.19, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Tepelenë  
“Sheshi Lord Bajron”, Tepelenë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se operatori ekonomik ankimues ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka pranuar pjesërisht atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datë 17.04.2017 është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-05987-04-13-2017, me objekt “Sistemim Asfaltim Rruga Dragot –Pasarele”, me fond limit 46.796.083 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 15.05.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tepelenë.

II.2. Në datën 19.04.2017 operatori ekonomik “Cobial” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

*“Operatori ekonomik “Cobial” Shpk ankohet mbi kërkesat për kualifikim të procedurës së prokurimit me objekt “Sistemi i Asfaltimit rrugor Dragot-Pasarele (lotil)”, që zhvillohet në datë 15/05/2017 nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tepelene për pikat si më poshtë:*

*1. Në dokumentat e tenderit kërkohet që operatori ekonomik, duhet të ketë një punësim mesatar prej jo më pak se 100 punonjësish të siguruar, për periudhën janar 2016-shkurt 2017. Kërkojmë ndryshimin e këtij kriteri për shkak se numri i punonjësve të kërkuar është shumë i ekzagjeruar, pasi ky numër ka tejkaluar natyrën dhe përmasat e kontratës pasi një numër i tillë punonjësish është i pa arsyetuar teknikisht dhe teresisht joproporcional me volumet e punimeve të objektit që prokurohet.*

*2. Në dokumentat e tenderit kërkohet që operatori ekonomik, duhet të ketë*

*1 Inxhinier Ndertimi (profil transport- infrastrukture)*

*1 Inxhinier Hidroteknik*

*1 Inxhinier Mjedisi (profili energjistik)*

*1 Inxhinier Gjeodet*

*1 Inxhinier Mekanik*

*1 Inxhinier Gjeolog*

*Zerët e punës në preventivin e punimeve nuk përputhen me natyrën dhe në sasinë për specialitetet si më poshtë:*

*-Asnjë nga zerët e punës nuk përputhet me natyrën e punës për të pasur vlerësimin e Inxhinierit Hidroteknik si vepra të ndryshme hidroteknike, pasi ka për të zbatuar vetëm punime të zakonshme ndertimi si germime për ndertimin e e trupit të rrugës dhe ndertim vepra të vogla arti në rrugë, të cilat kryhen nga cdo inxhinier ndertimi.*

*-Asnjë nga zerët e punës nuk përputhet me natyrën e punës për të pasur vlerësimin e Inxhinierit të Mjedisit dhe aq më tepër të profilit energjistik si zvogëlim të ndikimit të impaktit në mjedis të vepra të ndryshme energjitike. Në këto kontrata nuk kërkohet ndertimi i ndonjë veprë energjitike.*

*-Asnjë nga zerët e punës nuk përputhet me natyrën e punës për të pasur vlerësimin e Inxhinierit Mekanik si punime të ndryshme mekanike apo ndertimi i elementeve metalik.*

*Kërkesa për Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Mjedisi energjistik dhe Inxhinier Mekanik për mendimin tonë duhet të hiqet mbasi del jashtë natyrës së objektit që prokurohet.*

*3. Kërkojmë heqjen e certifikatave të mëposhtme:*

*-certifikates për menaxhimin sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001:2013, të vlefshme për shkak: se këto kontrata nuk kanë asnjë informacion të klasifikuar apo përdorimin e ndonjë teknologjie të vecante e cila kërkon mbrojtje të të dhënave të saj, aq më tepër që këto janë fonde*

publike dhe cdokush ka te drejten e informimit dhe mendojme se duhet te zbatohen ligjet e Shtetit Shqiptar qe jane ne fuqi ne lidhje me informacionin.

-certifikates per sistemin e menaxhimit te pergegjesise shoqerore SA 8000:2014, te vlefshme per shkak se kjo kerkese mbivendoset me kerkesat e tjera te kerkuar ne kete tender. Fusha e veprimit te kesaj certificate eshte puna e te mitureve, puna e detyruar, shendeti dhe siguria ne pune, masat kunder diskriminimit, kohezgjatja e punes dhe pagesat e punonjesve brenda rregullave dhe standarteve.

Per te verifikuar punen e te miturve, punen e detyruar, masat kunder diskriminimit, kohezgjatjen e punes dhe pagesat e punonjesve brenda rregullave dhe standarteve, autoriteti kontraktor ka ne dispozicion te gjitha listepagesat dhe vertetimet ligjore ne lidhje me aktivitetin dhe per te verifikuar shendetin dhe sigurine ne pune ka kerkuar OHSAS 18001:2007 e cila eshte certificate per menaxhimin e shendetit dhe sigurise se punonjesve ne pune.

-certifikates per sistemin e menaxhimit te cilesise ne saldim En-ISO 3834-2:2006 pasi nuk eshte ne perputhje me natyren e kontrates dhe ne asnje nga zerat e punimeve. Sipas dokumentave te tenderit te publikuar, vetem ne "Arnim pusete te tombinove" dhe "Tombino rrugore arnim Tombino 800" ka detaje te punimit te hekurave te armimit por ne asnje rast nuk percaktohet qe xhuntimi i shufrave te hekurit do te kryhet me saldim.

-Kerkojme heqjen e certifikates per sistemin e menaxhimit te qendrueshmerise se eventeve ISO 20121:2012 pasi nuk eshte ne perputhje me natyren e kontrates. Ne gjykimin tone termi event nuk ka te beje fare me punimet e ndertimit pasi asnje prej zerave te punimeve nuk i nevojitet procesi i menaxhimit te eventit.

4.(i) Ne preventivin e kesaj kontrate asnje nga zerat e punes nuk perputhet me natyren e punes se Arkitetit si dizenjimi apo projektimi i elementeve te ndryshem arkitekture apo urbanistik, pasi ka per te zbatuar vetem punime te zakonshme ndertim si germime per ndertimin e trupit te rruges, ndertimi i veprave te vogla te artit (mure e tombino) ne rruge dhe ndertimin e shtresave rrugore te cilat kryhen nga cdo inxhinier ndertimi. Per me teper qe rruga eshte ekzistuese.

(ii) Ne preventivin e kesaj kontrate asnje nga zerat e punes nuk perputhet me natyren e punes se Inxhinierit Strukturist si projektimi i elementeve te ndryshem strukturor betonarme ose te ndonje materiali tjetër, por ka per te zbatuar vetem punime te zakonshme ndertim si germime per ndertimin e e trupit te rruges, ndertimi vepra te vogla te artit ne rruge dhe ndertimin e shtresave rrugore te cilat kryhen nga cdo inxhinier ndertimi.

(iii) Kerkesa per nje person te trajnuar pergjegjes per sigurine dhe higjenen ne kantieret e perkohshme te ndertimit. Sipas ligjit eshte drejtuesi teknik i kantierit personi qe eshte pergjegjes per sigurine dhe higjenen ne kantieret e perkohshme te ndertimit.

Insistojme qe ky kriter te hiqet mbasi eshte i qellimshem per te kufizuar numrin e pjesmarresve

5. (i) *Vendosja e 4 karpentiereve eshte me i madhe se sa duhet.*
- (ii) *Vendosja e 4 teknikeve ndertimi per te ndertuar vetem 1850 m rruge shume i ekzagjeruar.*
- (iii) *Kerkesa per 1 saldator ku ne asnje nga zerat e preventivit nuk nevojitet procesi i saldimit dhe nuk eshte ne perpudhje me natyren dhe permasat e kontrates eshte e pa justifikueshme.*
- (iv) *Kerkesa e 2 mekanikeve ku ne asnje nga zerat e preventivit nuk nevojiten procese pune te mekanikut dhe nuk eshte ne perputhje me natyren dhe permasat e kontrates eshte e pajustificueshme.*
- (v) *Kerkesa e 1 Hidroizolues ku ne asnje nga zerat e preventivit nuk nevojitet procese pune te hidroizoluesit dhe nuk eshte ne perputhje me natyren dhe permasat e kontrates gjithashtu eshte e pajustificueshme.*
- (vi) *Vendosja e punonjesve te kualifikuar, per realizimin e punimeve me mjete te ndryshme si 10 shofere dhe 7 manovratore nuk jane ne perputhje me permasat e kontrates.*
- Insistojme ne heqjen e ketij kriteri, pasi keto kerkesa sipas arsytimit tone jane te pa bazuar ne normativat e manualeve te miratuara dhe jane vendosur qellimisht te shkeluar barazine ne tendera dhe per te kufizuar pjesmarrjen duke paramenduar fituesin.*

6. *Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates.*

*Makinerite dhe pajisjet e kerkuar ne kete kriter shkelin hapur barazine ne tender duke favorizuar operatore te vecante per shkak se mjetet e vendosura jane te teperta dhe nuk jane ne perputhje me permasat e kontrates sic tregohet dhe ne tabelat e zberthimit te analizave per zerat e punimeve sipas VKM Nr. 629 date 15.07.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre", par jane vendosur per te skualifikuar operoret pjesemarrres ne tender dhe me qellim per te paracaktuar fituesin.*

(i) *Ne kete kriter kerkohen "Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 40 ton secili" Kjo eshte jashte parametrave ligjore per shkak se, sipas kodit rrugor dhe rregullores se zbatimit te kodit rrugor, sipas VKM Nr 153 date 07.04.2000 "Per miratimin e rregullores se zbatimit te kodit rrugor" percaktohet masa maksimale e autorizuar e mjeteve 8 ton per aks dhe numri maksimal i akseve eshte 5 per mjet, pra masa maksimale e autorizuar eshte 40 ton duke perfshire dhe masen e automjetit bosh e cila eshte e vendosur dhe ne lejete e qarkullimit te mjeteve dhe sipas Kodit Rrugor, nuk lejhen ngarkesa me te medha se 24 t.*

*Kerkojme ndryshimin e ketij kriteri dhe vendosjen e tij ne perputhje me ligjin .*

(ii) *kerkesa per "Shtruese asfalti" 2 cope, eshte i pa justifikuar me volumet e punes qe do te kryhen ne kete kontrate .*

(iii) *Kerkohen*

1. Fadrome tema ose Skrep cope 3 (tre)
2. Eskavator me goma cope 2 (dy)
3. Eskavator me zinxhir cope 1 (nje)

Volumet e punes qe ka preventivi per germimet dhe ngarkimet e materialeve ne objekt mbeshtetur ne normivat teknike dhe ne kapacitetet dhe rendimentin e makinerive germuese kerkojne jo me shume se tre mjete germimi. Numuri i kerkuar nga autoriteti kontraktues eshte shume i madh dhe i pa justifikuar teknikisht.

(iv) Kerkohen

1. Freze asfalti me zinxhir me gjeresi 1.5 m cope 1 (nje)
2. Gjenerator 20 Kva cope 1 (nje)

Kerkesa per keto mjete eshte e tepmar per shkak se ne asnje nga zerat e preventivit nuk ka punime per te perdorur te tilla makineri.

(v) Kerkohet

1. Linje prodhim prajmeri cope 1 (nje)

Ky kriter eshte teresisht i tepruar dhe i qellimshem per diskriminuar operatore ekonomik pasi prajmeri eshte nje produkt qe blihet ne treg si cimeno, hekur, etj. Mjafton qe te jete brenda specifikimeve teknike te kesaj kontrate.

(vi) Kerkohet:

1. Impiant i prodhimit te bitumeve specifike cope 1 (nje)

Si me siper ky kriter eshte teresishte i pa vend dhe i qellimshem per te diskriminuar operoret ekonomike pasi bitumi eshte nje produkt qe blihet ne treg si cimeno, hekur, etj. Per me teper sipas specifikimeve teknike te kesaj kontrate, bitumi qe duhet te perdoret per te realizuar zerat e punimeve ne kete kontrate eshte sipas standarteve Stash 660- 87 ose te STASH CNR Nr. 1996 "Karakteristika per pranim" i cili nuk eshte ndonje material i jashtezakonshem par produkt qe prodhohet e tregtohet nga Uzinat e Perpunitimit te Naftes ne vend te cilat e shoqerojne mallin dhe me flete analizat e duhura ne te njejten menyre qe shoqerohet hekuri, cimentoja apo boja bikomponente per vijezimin e rrugeve, per karakteristikat e kerkuara. Investitori ka te drejten te ndjeke zbatimin e kontrates sipas specifikimeve teknike qe ka dhene, duke kerkuar njekoheisht dhe flete analizat per materialet qe dote kontrolloje. Kerkesa te tilla duken jashte logjikes mbasi perpunimi i naftes dhe i nenprodukteve te saj ka teknologji te vecante dhe per mendimin tone nuk eshte pune qe mund dhe duhet te behet nga shoqerite e ndertimit.

Pra kriteret per makinerite jane vendosur apriori.

Si perfundim, mbeshtetur dhe ne eskperienat e deritanishme, gjykojme se kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tepelene, jane diskriminuese dhe synojne qe te minimizojne numurin e konkurrenteve duke here qe te paracaktohet fituesi i gares. Nje gje e tille, per



*mendimin tone, eshte ne kundersizim me Ligjin dhe rregullat e prokurimit Publik prandaj kerkojme ndryshimin e ketyre kritereve”.*

II.3. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. prot.503/1, datë 21.04.2017 i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Cobial” shpk në lidhje me pretendimet e ngritura prej tij duke deklaruar mospranimin e ankesës.

II.4. Në datën 27.04.2017 operatori ekonomik “Cobial” sh.k, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në të cilën paraqet të njëjtat pretendime sikurse edhe në autoriteti kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 569/1 prot., datë 08.05.2017, protokolluar me tonën me nr. 841/2, datë 09.05.2017me objekt “*Informacion*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “Cobial” shpk se “*Numri punonjese te kerkuar në DST prej jo me pak se 100 punonjes eshte shume i ekzagjeruar, pasi ky numer ka tejkaluar natyren dhe permasat e kontrates pasi nje numer i tille punonjesh eshte i pa arsyetuar teknikisht dhe teresisht joproporcional me volumet e punimeve te objektit qe prokurohet, prandaj duhet modifikuar*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.2 është kërkuar si më poshtë vijon:

*“2.3.2-Operatori ekonomik, duhet të ketë një punesim mesatar prej jo me pak se 100 punonjeshish të siguruar, për periudhën janar 2016-shkurt 2017 të vërtetuar me;*

i. *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku te specifikohet numri i punonjese per secilin muaj per periudhën Janar 2016 – dhjetor 2016 dhe Janar 2017– shkurt 2016 .*

ii. *Listepagesa e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi (Formulari numer E-SIG 025/a.1) per periudhen Janar 2016 – dhjetor 2016 dhe Janar 2017– shkurt 2016 .”*

III.1.2. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.1.3. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.4.Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se *“Kontratat për punë publike” janë kontratat publike, që kanë objekt realizimin, projektimin dhe realizimin e punimeve apo të punës ose realizimin me gfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me kërkesat e përcaktura nga autoriteti kontraktor.*

III.1.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma “b” parashikohet si më poshtë:

*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

*b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”*

III.1.6. Në interpretim literal të bazës ligjore të sipërcituar Komisioni vlerëson se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Referuar preventivit të punimeve, specifikimeve teknike si dhe kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit vërehet se ky i fundit kërkon të realizojë “Sistemim Asfaltim Rruga Dragot –Pasarele”, për një afat 3 mujor.

Megjithatë referuar kriterit për vërtetimin e disponimit nëpërmjet listpagesave për jo më pak se 100 punonjës, Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor ka tejkalluar natyrën dhe përmasat e kontratës pasi një numër i tillë punonjësish është tërësisht joproporcional me objektin e prokurimit. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme të provohet disponimi i punonjësve por kjo duhet të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme duke pasur parasysh elementë të tillë si natyra e kontratës dhe volumi i saj, për më tepër kur vetë autoriteti kontraktor ka parashikuar një afat të shkurtër për realizimin e kontratës.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të



sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Komisioni vlerëson se kriteri i sipërcituar nuk është hartuar tërësisht në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik pasi ka kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë duke përfshirë në të vetëm ata operatorë të cilët plotësojnë numrin e kërkuar prej jo më pak se 100 punonjës, duke përjashtuar kështu operatorë të tjerë ekonomikë të cilët edhe pse mund të garantojnë punë të ngjashme me objektin si dhe mund të përmbushin të gjitha kriteret kualifikuese për këtë procedurë prokurimi do të penalizohen vetëm për faktin se nuk përmbushin numrin e kërkuar të punonjësve e cila në rastin konkret nuk është i argumentuar dhe justifikuar nga autoriteti kontraktor.

Në këtë kuptim Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa më sipër duke përcaktuar një numër të arsyeshëm dhe proporcional me volumin e punimeve të nevojshme që do të kryhen për realizimin e kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP .

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Cobial” shpk. qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Cobial” shpk se “1. *Kerkesa per Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Mjedisi energjistik dhe Inxhinier Mekanik per mendimin tone duhet te hiqet mbasi del jashte natyres se objektit qe prokurohet* 2. *Insistojme qe kriteri per te patur ne staf Arkitet, Inxhinier Strukturist dhe nje person te trajnuar pergjegjes per sigurine dhe higjenen ne kantieret e perkohshme te ndertimit te hiqet, pasi ne preventivin e kesaj kontrate asnje nga zerat e punes nuk perputhet me natyren e punes se ketyre profesioneve* 3. *Insistojme ne heqjen e ketij kriteri per disponimin e 4 karpentiereve, 4 teknikeve te ndertimi, 1 saldatori, 2 mekanikeve, 1 hidroizoluesi si dhe uljen e numrit te punonjesve te kualifikuar, per realizimin e punimeve me mjete te ndryshme si 10 shofere dhe 7 manovratore, pasi nuk jane ne perputhje me permasat e kontrates*”; Komisioni i Prokurimit Publik vëren se

III.2.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3, 2.35 dhe 2.3.4 është kërkuar si më poshtë vijon:

« 2.3.3- *Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion për stafin drejtues teknik, të përfshirë në licensë:*

- *1 Inxhinier Ndërtimi (profil transport- infrastrukture)*
- *1 Inxhinier Hidroteknik*
- *1 Inxhinier Mjedisi (profili energjistik)*

- 1 Inxhinier Gjeodet
- 1 Inxhinier Mekanik
- 1 Inxhinier Gjeolog

iii. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontratën e punës, diplomën përkatëse, librezën e punes, CV dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (IQT). Në CV-në e tyre, duhet të pasqyrohet eksperiencë pune jo me pak se 5 vjet dhe duhet të jenë të përfshirë në listpagesat e shoqerise.

2.3.5- Për realizimin e punimeve Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij:

- Operatori ekonomik duhet te kete 1 Arkitekt, te perfshire ne listepagese, per te cilin duhet te paraqitet kontrata e punës, diploma përkatëse, librezë e punes, CV, dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (IQT).
- Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij edhe 1 inxhinier ndërtimi, si inxhinier strukturist, të përfshirë në listëpagesë, për të cilin të paraqitet kontrata e punës, diploma përkatëse, librezë e punes, CV, dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (IQT).
- Operatori ekonomik duhet te ketë në stafin e tij, nje person te trajnuar per: Ndhimen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave, i përfshirë në listëpagesë. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e lëshuar nga Organizma Çertifikimi, të Akredituar.
- Operatori ekonomik duhet te ketë ne stafin e tij, nje person te trajnuar: Pergjegjes per sigurine dhe higjenen ne kantieret e perkohshme te ndertimit, i përfshirë në listëpagesë. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e lëshuar nga Organizma Çertifikimi, të Akredituar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te ketë ne stafin e tij, nje person te trajnuar per: Vleresimi dhe dokumentacioni i vleresimit te risqeve ne kantier, Sipas Ligjit Nr.10237, date 18.2.2010 "Per sigurine dhe Shendetin ne Pune", i përfshirë në listëpagesë.", VKM nr.312 date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier".

- Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e lëshuar nga Organizma Çertifikimi, të Akredituar. (IQT)

- *Operatori ekonomik duhet të duhet te ketë ne stafin e tij punonjës të kualifikuar për realizimin e zërave të veçanta të punimeve, minimalisht si më poshtë:*

- Karpentier* 4 (katër)
- Teknik Ndertimi* 4 (katër)
- Saldator* 1 (një)
- Mekanik* 2 (dy)
- Hidroizolues* 1 (një)

*Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë*

- a) kontratën individuale të punës;*
- b) një dokument (dëshmi kualifikimi profesional /diplomë), që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;*
- c) dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.*

*Operatori ekonomik duhet të duhet te ketë ne stafin e tij punonjës të kualifikuar, për realizimin e punimeve me mjete të ndryshme. Për këtë duhet të ketë në stafin e tij të paktën 10 shoferë, për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë lejen e drejtimit të tyre, dhe 7 manovratorë, për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshminë e manovrimit.*

III.2.2. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5 dhe pika 8, gërma “a” përcaktohet:

*“5. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

*8. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”.*

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor mbi përcaktimin stafit teknik dhe punonjësve të kualifikuar më konkretisht:

-kërkesa për inxhinier hidroteknik dhe inxhinier mjedisi (profili energjitik);  
-kërkesa për arkitekt ;  
-kërkesa për saldator;  
-kërkesa për hidroizolues, janë kërkesa të ekzagjeruara, në tejkalim të kontratës objekt prokurimi dhe të dispozitave ligjore përkatëse mbi prokurimet, duke patur parasysh dhe zërat e parashikuara në preventivin e punimeve dhe statusin e rrugës (rrugë ekzistuese) ku do të kryhen punimet e asfaltimit. Komisioni gjykon se kërkesa sa më sipër e autoritetit kontraktor, duhet modifikuar, duke hequr kategoritë e lartpërmendura të stafit teknik dhe punonjësve të kualifikuar.

III.2.4. Gjithashtu Komisioni gjykon se kërkesa për 4 karpentierë, 4 teknikë ndërtimi, 2 mekanikë; janë kërkesa të ekzagjeruara, në tejkalim të kontratës objekt prokurimi, duke patur parasysh se zërat e parashikuara në preventivin e punimeve, për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të ulë numrin e tyre në përputhje me objektin e prokurimit, volumin e punës dhe preventivin e punimeve.

III.2.5. Ndërkohë Komisioni gjykon se:

- kërkesa për disponim të një inxhinieri mekanik, një inxhinieri strukturist dhe një personi përgjegjës për sigurinë dhe higjienën;  
-kërkesa për 10 manovratorë dhe 7 shoferë; janë kërkesa në përputhje me kontratën objekt prokurimi, duke patur parasysh legjislacionin në fuqi, zërat e parashikuara në preventivin e punimeve dhe mjetet dhe pajisjet teknike që do të përdoren për realizimin e kësaj kontrate.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Cobial” shpk qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e ankimesit “Cobial” shpk se *“te hiqet kriteri për paraqitjen e:*

*-certifikates per menaxhimin sigurise se informacionit ISO/IEC 27001:2013*

*-certifikates per sistemin e menaxhimit te pergegjesise shoqerore SA 8000:2014*

*-certifikates per sistemin e menaxhimit te cilesise ne saldim En-ISO 3834-2 : 2006*

*- certifikates per sistemin e menaxhimit te qendrueshmerise se eventeve ISO 20121:2012 pasi nuk jane ne perputhje me natyren e kontrates.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.4 është kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.4- *Operatori ekonomik duhet te disponoje certifikatat e meposhtme:*

a. *Sistemi i menaxhimit te cilesise EN ISO 9001:2008, te vlefshme.*

b. *Sistemi i menaxhimit te mjedisit EN ISO 14001:2004, te vlefshme.*

c. *Sistemi i menaxhimit te shendetit dhe sigurise se punonjesve ne pune OHSAS 18001:2007, te vlefshme.*

d. *Sistemi i integruar i menaxhimit PAS 99: 2012, te vlefshme.*

- e. *Sistemi i menaxhimit te sigurise rrugore BS ISO 39001:2012, te vlefshme.*
- f. *Per menaxhimin e sigurise se informacionit ISO/IEC 27001:2013, te vlefshme.*
- g. *Per sistemin e menaxhimit te pergjegjesise shoqerore SA 8000:2014,te vlefshme.*
- h. *Per sistemin e menaxhimit te energjise ISO 50001 : 2011, te vlefshme.*
- i. *Per sistemin e menaxhimit te cilesise ne saldim En-ISO 3834-2 : 2006, te vlefshme.*
- j. *Per sistemin e menaxhimit te qendrueshmerise se eventeve ISO 20121:2012, te vlefshme*

III.3.2. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

Në nenin 46 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]”

III.3.3. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 30 “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se:

“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.3.4. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

- *Certifikata ISO/IEC 27001:2013, specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit, brenda kontekstit të organizatës. Ajo gjithashtu përfshin kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë të informacionit të përshatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë.*

-*Certifikata SA 8000:2014, krijon një standard certifikimi të përputhshmërisë sociale, e cili inkurajon organizatën të zhvillohet, të mbajë dhe të aplikojë praktika të pranueshme sociale në vendin e punës dhe të sigurojë udhëzime për punonjësit përsa i përket çështjeve të ndryshme si marrja në punë, pagesa, akses në trajnim, promovim, përfundim të marrëdhënies së punës apo*



*daljes në pension; të cilat nuk janë bazuar ne racë, origjinë kombëtare, territoriale apo sociale, kastë, lindje, fe, paftësi, gjini, orientim seksual, përgjegjësi familjare, statusi civil, anëtarshi në unione, opinione politike, moshë apo çdo lloj kushti që mund të çonte në diskriminim.*

*-Certifikata EN ISO 3834-2 :2006 specifikon kërkesat për proceset e saldimit, i përdorur gjerësisht në prodhimin industrial dhe në shumë ndërmarrje dhe luan rol të rëndësishëm në mesin e teknologjive të prodhimit. Nga pikëpamja e rritjes së kërkesave në aspektin e cilësisë dhe sigurisë së këtyre produkteve, është e rëndësishme për të siguruar, që proceset saldimit kryhen në mënyrë efektive duke përdorur të gjitha instrumentet e duhura të kontrollit.*

*- Certifikata ISO 20121:2012 specifikon kërkesat për sistemin e menaxhimit të qëndrueshmërisë së eventeve për çdo lloj event, apo aktiviteti të lidhur me këto evente dhe jep udhëzime në konfirmimin e këtyre kërkesave.*

III.3.5. Lidhur me kriterin e parashikuar për paraqitjen e *Certifikata ISO/IEC 27001:2013, EN ISO 3834-2:2006, ISO 20121:2012, SA 8000:2014* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se vendosja e këtij kriteri është i ekzagjeruar dhe jo në përpjestim të drejtë me volumin e kontratës, objektin e prokurimit dhe të zërave të punimeve të parashikuara në preventiv. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor me qëllim realizimin me sukses të kontratës duhet të heqë si kriter kërkesën për paraqitjen e certifikatave *ISO/IEC 27001:2013, EN ISO 3834-2:2006, ISO 20121:2012, SA 8000:2014.*

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes "Cobial" shpk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e ankimesit "Cobial" shpk se "*kërkesa për kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 40 ton, është kriter i paligjshëm, prandaj duhet ndryshuar*", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 10 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 2.3.6 është kërkuar si më poshtë vijon:

*2.3.6- Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion Operatorit Ekonomik.*

III.4.2. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, 6 kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;"*



Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.4.3. Neni 26, pika 8, gërma “c”, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.4.4. Ligji Nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Neni 62, pika 1, Neni 54, pika 1, gërma “d” dhe “l” dhe neni 10, pika 1 dhe 8 përcakton se:

Neni 62 “Ngarkesat”

1. Pesha kufitare e përgjithshme me ngarkesë të plotë e një mjeti, që përbëhet nga pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe nga ajo e ngarkesës së tij, duke përjashtuar rastet e përcaktuara në nenin 10 dhe në pikat 2, 3, 4, 5 e 6 të këtij neni, nuk mund të jetë më e madhe se 5 tonë për aks për mjetet me një aks, 8 tonë për aks për ato me dy akse dhe 10 tonë për aks për ato me 3 e më shumë akse.

Neni 54 “Automjetet “

1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove. Automjetet ndahen në:

d) kamion: mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe tënjerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave;

l) makina ngarkim-transporti: mjete ose komplekse mjetesh që kanë pajisje të veçanta për ngarkimin dhe transportin e materialeve që përdoren, ose janë produkt i punimeve të ndërtimit dhe të gërmimeve në miniera, si dhe të materialeve që plotësojnë gjatë ecjes ciklin e prodhimit të tyre; këto mjete ose komplekse mjetesh mund të përdoren në transporte që kalojnë kufirin e ngarkesës të përcaktuar në nenin 62, por jo atë të nenit 10, pika 8; në çdo rast nuk duhet të kalojnë përmasat gabarite kufitare të përcaktuara në nenin 61; makinat e ngarkimtransportit duhet, gjithashtu, të jenë të përshtatshme për t'u përdorur në kantiere ose për përdorim të përzier në rrugë dhe jashtë saj.

Neni 10

Mjetet jashtë norme dhe transportet në kushte jonormale

1. Konsiderohet jashtë norme mjeti që i kalon, për kërkesa funksionale të veçanta, kufijtë e përmasave gabarite dhe kufijtë e ngarkesave të përcaktuara në nenet 61 dhe 62.

8. *Pesha maksimale për ngarkesë të plotë të makinave të ngarkimtransportit, me kusht që aksi më i ngarkuar të mos e kalojë ngarkesën 13 tonë, nuk duhet të jetë më e madhe se:*

*a) mjete teke me motor:*

*- me dy akse: 20 tonë*

*- me tri akse: 33 tonë*

*- me katër ose më shumë akse, me dy akse të përparme drejtuese: 40 tonë;*

*b) kompleks mjetesh:*

*- me katër akse: 44 tonë*

*- me pesë ose më shumë akse: 56 tonë*

*- me pesë ose më shumë akse, për transportin e betonit me betoniere: 54 tonë.*

III.4.5. Komisioni i Prokurimit Publik referuar dhe bazës ligjorë të mësipërme, vlerëson se kamioni vetshkarkues nuk mund të kategorizohet si mjet transporti i mallrave, por si mjet ngarkim transporti, i cili do të përdoret për ngarkimin dhe transportin e materialeve që përdoren për punimet që do të kryhen për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për këtë arsye dhe duke patur parasysh se referuar natyrës së mjetit në fjalë - pra kamion vetëshkarkues-, i cili kategorizohet tek mjetet teke me motor (pika 8, gërma “a” e Kodit Rrugor), në të cilin përcaktohet se maksimumi i tonazhit me katër ose më shumë akse, me dy akse të përparme drejtuese është 40 tonë; Komisioni gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor bien ndesh me dispozitën e sipërcituar të Kodit Rrugor, e për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet të marrë masat e nevojshme për të modifikuar kriterin në fjalë, duke ulur masën e tonazhit të kërkuar.

Pra pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “Cobial” shpk se “*kërkesa për linjë prodhim prajmeri dhe impiant të prodhimit të bitumeve është një kërkesë e ekzagjeruar, prandaj duhet të hiqet*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.6 është kërkuar si më poshtë vijon:

*2.3.6- Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion Operatorit Ekonomik.*

*Kërkohen të jenë në dsipozicion këto mjete pune:*

19. *Linje prodhim prajmeri cope 1 (një)*

21. *Impiant i prodhimit te bitumeve specifike cope 1 (një)*”

- *Linja e prodhimit te prajmerit kur është ne pronesi duhet te shoqerohet me dokumentin që vërteton pronesinë e saj dhe Raportin e inspektimit per konformitetin e makinerise, i vlefshëm.*

*Në rastin kur është me qera ose kontratë furnizimi të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të objektit, shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës të qeradhënsit/furnizuesit, dokumentacionin e pronesise, dhe raport inspektimin per konformitetin e makinerise, i vlefshëm.*

- *Impianti i prodhimit te bitumeve specifike kur është në pronesi duhet te shoqerohet me dokumentin që vërteton pronesinë e tij, leje mjedisore kodi III.2.B, III.1.C dhe karten teknologjike mbi prodhimin e bitumeve specifike.*

- *Në rastin kur është me qera ose kontratë furnizimi të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të objektit, shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës të qeradhënsit/furnizuesit, dokumentin që vërteton pronesinë e tij, leje mjedisore kodi III.2.B, III.1.C dhe karten teknologjike mbi prodhimin e bitumeve specifike”.*

III.5.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet:

*“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese: aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.5.3. Në nenin 26 “Kontratat për punë publike” , pika 8 gërma “c” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

*“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’I vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

III.5.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një interpretim të zgjeruar të nenit 46 pika 1 gërma “b” të LPP-së dhe nenit 26 pika 8 gërma “c” të aktit normative në zbatim të ligjit VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike) i nenit 46 pika 1 gërma “b” K.P.P. gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që me anë të dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë të vërtetohet plotësimi i kapacitetit teknik të tyre në drejtim të kapaciteteve organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. Akoma më tej në nenin 26 pika 8 gërma “c”, parashikohet se për përmbushjen e kapacitetit teknik operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë dëshmi për mjete dhe paisje pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.5.6. Në lidhje me kërkimin e operatorit ekonomik “Cobial” shpk se “ *kërkesa për linjë prodhim prajmeri dhe impiant të prodhimit të bitumeve është një kërkesë e ekzagjeruar, prandaj duhet të hiqet*”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kriteri i vendosur në pjesën e kapacitetit teknik në drejtim të vërtetimit të disponueshmërisë së linjës prodhim prajmeri dhe impiant të prodhimit të bitumeve, është një kriter i drejtë dhe jopërrjashtues, përse kohë ju ka krijuar operatorëve ekonomikë një gamë opsionesh që variojnë nga pronësia, tek kontrata me qira dhe kontrata e furnizimit. Komisioni gjykon se kriteri *për linjë prodhim prajmeri dhe impiant të prodhimit të bitumeve* do të ishte përjashtues, vetëm në rast se kërkesa do t’i referohej vetëm mundësisë për të vërtetuar diponueshmërinë e këtyre linjave me anë të pronësisë apo kontratës së qirasë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se vetë autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi ka parashikuar mundësinë e disponimit të materialeve të mësipërme edhe me anë të kontratave të furnizimit, parashikuar në shtojcën 10, “Kriteret e e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se me anë të kontratës së furnizimit, si një kontratë e veçantë e pranuar nga Kodi Civil e cila jep garanci të plota për autoritetin kontraktor për mundësinë e disponimit të furnizimit me materialet e kërkuara në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor pasqyruar në kriteret e veçanta të kualifikimit si edhe në zbatim të nenit 46 pika 1 gërma “b” të LPP-së dhe nenit 26 pika 8 gërma “c” të VKM 914/2014, i jepet mundësinë të gjithë operatorëve ekonomikë pjesmarrës të mundshëm në procedurën e prokurimit në fjalë, të mund të vërtetojnë se disponojnë mjetet e kërkuara për zbatimin e kontratës në zbatim të nenit 26 pika 8 gërma ”c” të VKM 914/2014.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “Cobial” shpk se “, duhet ulur numri i disa prej makinerive të kërkuara”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.6 është kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.6- *Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion Operatorit Ekonomik.*

*Kërkohen të jenë në dsipozicion këto mjete pune:*

- |     |                                                                        |                     |
|-----|------------------------------------------------------------------------|---------------------|
| 1.  | <i>Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 40 ton secili</i> | <i>cope</i>         |
|     | <i>6(gjashtë)</i>                                                      |                     |
| 2.  | <i>Kamion vinç</i>                                                     | <i>cope 1</i>       |
|     | <i>(një)</i>                                                           |                     |
| 3.  | <i>Autopompe per hedhje betoni</i>                                     |                     |
|     | <i>cope 1(një)</i>                                                     |                     |
| 4.  | <i>Autobetoniere</i>                                                   | <i>cope 3</i>       |
|     | <i>(tre)</i>                                                           |                     |
| 5.  | <i>Grejder mjet nivelues</i>                                           | <i>cope 1</i>       |
|     | <i>(një)</i>                                                           |                     |
| 6.  | <i>Fabrike asfalti</i>                                                 | <i>cope</i>         |
|     | <i>1(një)</i>                                                          |                     |
| 7.  | <i>Shtruese asfalti</i>                                                |                     |
|     | <i>cope 2 (dy)</i>                                                     |                     |
| 8.  | <i>Autobot bitumi</i>                                                  |                     |
|     | <i>cope 1 (nje)</i>                                                    |                     |
| 9.  | <i>Autobitumatrice</i>                                                 | <i>cope 1 (një)</i> |
| 10. | <i>Fshese per rruget</i>                                               | <i>cope 1</i>       |
|     | <i>(një)</i>                                                           |                     |
| 11. | <i>Rul ngjeshes 10 - 15 ton</i>                                        |                     |
|     | <i>cope 1(një)</i>                                                     |                     |
| 12. | <i>Rul ngjeshes 5 - 8 ton</i>                                          | <i>cope 2 (dy)</i>  |



13.	<i>Fadrome terna ose Skrep</i>		<i>cope 3 (tre)</i>
14.	<i>Eskavator me goma</i> <i>cope 2 (dy)</i>		
15.	<i>Eskavator me zinxhir</i> <i>(një)</i>		<i>cope 1</i>
16.	<i>Freze asfalti me zinxhir me gjerësi 1.5 m</i> <i>(një)</i>		<i>cope 1</i>
17.	<i>Gjenerator 20 Kva</i> <i>(një)</i>		<i>cope 1</i>
18.	<i>Sharre per prerje asfalti</i> <i>1(një)</i>		<i>cope</i>
19.	<i>Linje</i> <i>cope 1 (një)</i>	<i>prodhim</i>	<i>prajmeri</i>
20.	<i>Linje</i> <i>cope 1 (një)</i>	<i>prodhim</i>	<i>inertesh</i>
21.	<i>Impiant i prodhimit te bitumeve specifikë</i> <i>1 (një)</i>		<i>cope</i>

*Si dhe të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:*

- *Kokore minimumi 70 copë*
- *Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë*
- *Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 6 copë*
- *Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 19 copë*

*Operatori Ekonomik të paraqesë deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, per makinerite dhe mjete e mesiperme.*

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publike, kur janë në pronësi, duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikaten e kontrollit teknik, siguracion, leja e transportit nga komuna/bashkia, certifikaten e pronesise. Të gjithë dokumentacioni duhet të jetë i vlefshëm. Per pajisjet dhe mjetet e tjera te paraqitet fature zhdoganimi ose fature tatimore e shitjes, origjinale ose kopje te noterizuar. Mjetet duhet te shoqerohen me foto.*



- Për mjetet dhe pajisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikaten e kontrollit teknik, siguracion, leja e transportit nga komuna/bashkia (te vlefshme) dhe certifikaten e pronësive. Për pajisjet dhe mjetet e tjera të paraqitet fature zhdoganimi ose fature tatimore e shitjes, origjinale ose kopje të noterizuar. Mjetet duhet të shoqerohen me foto.

- Fabrika e asfaltbetonit kur është në pronësi duhet të shoqerohet me dokumentin që vërteton pronësinë e saj, lejen mjedisore leshuar nga QKL kodi III.1.B, planvendosja dhe raport inspektimin për konformitetin e makinerise, i vlefshëm.

Në rastin kur është me qera ose kontratë furnizimi të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të objektit, shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës të qeradhënsit/furnizuesit, dokumentacionin e pronësive, lejen mjedisore leshuar nga QKL kodi III.1.B, planvendosja dhe raport inspektimin për konformitetin e makinerise, i vlefshëm.

- Linja e prodhimit të prajmerit kur është në pronësi duhet të shoqerohet me dokumentin që vërteton pronësinë e saj dhe Raportin e inspektimit për konformitetin e makinerise, i vlefshëm.

Në rastin kur është me qera ose kontratë furnizimi të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të objektit, shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës të qeradhënsit/furnizuesit, dokumentacionin e pronësive, dhe raport inspektimin për konformitetin e makinerise, i vlefshëm.

- Linja e prodhimit të inerteve kur është në pronësi duhet të shoqerohet me dokumentin që vërteton pronësinë e saj, lejen mjedisore leshuar nga QKL kodi III.1.B, planvendosjen, dhe Raport inspektimi për konformitetin e makinerise, i vlefshëm.

Në rastin kur është me qera ose kontratë furnizimi të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të objektit, shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës të qeradhënsit/furnizuesit, dokumentin që vërteton pronësinë e saj, lejen mjedisore leshuar nga QKL kodi III.1.B, planvendosjen, dhe Raport inspektimi për konformitetin e makinerise, i vlefshëm.

- Impianti i prodhimit të bitumeve specifike kur është në pronësi duhet të shoqerohet me dokumentin që vërteton pronësinë e tij, leje mjedisore kodi III.2.B, III.1.C dhe karten teknologjike mbi prodhimin e bitumeve specifike.

- Në rastin kur është me qera ose kontratë furnizimi të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të objektit, shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës të qeradhënsit/furnizuesit, dokumentin që vërteton pronësinë e tij, leje mjedisore kodi III.2.B, III.1.C dhe karten teknologjike mbi prodhimin e bitumeve specifike.

- *Për mjetet që nuk qarkullojnë, konkretisht: shtruese asfalti, fshese për rrugët, rrula ngjeshës 10-15 ton, rrulat ngjeshës 5-8 ton, Eskavatori me zinxhir, freze asfalti me zinxhir me gjërësi 1.5 m, sharrë për prerje asfalti, të paraqitet Raport inspektimi për konformitetin e makinerise, e vlefshme.*
- *Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzojë analizë teknike për të gjithë e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM Nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10.*
- *2.3.6 Grafiku i punimeve, ku zërat e punës, fuqisë punëtore dhe numrit të mjeteve të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit.*

*Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë zbatimit të punimeve në objekt. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

*Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”.*

III.6.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, 6 kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.6.3. Neni 26, pika 8, gërma “c”, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*

III.6.4. Referuar Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 përcaktohet:

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

III.6.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.6.6 Komisioni i Prokurimit Publik pas analizimit të zërave të punimeve që do të kryhen në objektin e prokurimit gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor mbi disponimin e makinerive “shtruese asfalti- 2 copë, fadromë terna ose skrep- 3 copë, eskavator me goma-2 copë” është një kriter i ekzagjeruar, jo në përpjestim me preventivin dhe zërat e punimeve, sepse numri i vendosur i këtyre makinerive i kalon nevojat për ekzekutimin e kontratës. Për rrjedhojë kriteri në fjalë nuk përmbush qëllimin për të cilin autoriteti kontraktor pretendon se është vendosur dhe si rezultat ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në kufizimin e konkurrencës në këtë procedurë prokurimi, duke rënë në kundërshtim me nenin 1, pika 2 e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

Në këtë kontekst autoriteti kontraktor duhet të bëjë vlerësimin dhe analizimin e zërave të punimeve dhe në përputhje me to, të bëjë në mënyrë analoge përcaktimin e numrit të makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, duke ulur numrin e tyre në përputhje me objektin e kontratës objekt prokurimi, natyrën dhe preventivin e punimeve.

III.6.7 Ndërsa përsa i përket kërkesës tjetër mbi disponimin e makinerive “1.frezë asfalti me zinxhir 2. eskavator me zinxhire dhe 3. gjenerator 20 kva”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri në fjalë i autoritetit kontraktor është në përpjestim të drejtë me objektin e kontratës, me preventivin dhe zërat e punimeve.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Cobial” shpk qëndron pjesërisht, pra qëndron në lidhje me pretendimin e ngritur për uljen e mjeteve “shtruese asfalti- 2 copë, fadromë terna ose skrep- 3 copë, eskavator me goma-2 copë”, por nuk qëndron për pretendimin për heqjen e kriterit për disponimin e “1.frezë asfalti me zinxhir, 2 eskavator me zinxhir dhe 3. gjenerator 20 kva”.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron pjesërisht.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e

rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

**Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Cobial” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-05987-04-13-2017, me objekt “Sistemim Asfaltim Rruga Dragot –Pasarele”, me fond limit 46.796.083 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 15.05.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tepelenë.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Cobial” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.841 Prot; Datë 27.04.2017**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**